



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË  
BORDI**

**VENDIM**

**Nr. 181, Datë 10.11.2017**

**MBI**

**MIRATIMIN E RREGULLORES “PËR KRITERET STANDARDE TË CILËSISË SË SHËRBIMIT TË FURNIZIMIT DHE PERFORMANCËS SË SIGURISË SË RRJETIT TË SHPËRNDARJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE”.**

Në mbështetje të neneve 7, pika 1; 16 dhe 19, gërma “h” dhe “j” të Ligjit Nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” si dhe nenit 26 të “Rregullores për Organizimin, Furnksionimin dhe Procedurat e ERE-s”, miratuar me Vendimin Nr. 96, datë 17.06.2016, të ERE, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 10.11.2017, pasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit në lidhje me miratimin e draft-“Rregullores për kriteret standarde të cilësisë së shërbimit të furnizimit dhe performancës së sigurisë së rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike”,

**Konstatoi se:**

- Me Vendimin nr. 95, datë 17.06.2016, Bordi i ERE-s vendosi fillimin e procedurave për shqyrtimin e draft- “Rregullores për Kushtet Minimale të Cilësisë së Shërbimit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike”.
- Me shkresën nr. 480 Prot., datë 22.06.2016, ERE u ka dërguar të gjitha palëve të treta dhe grupeve të interesit, draft - “Rregulloren për kushtet minimale të cilësisë së shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike”.
- Në shkresën e saj me nr. 480/1 Prot., i ERE, datë 04.07.2016, OST sh.a ka paraqitur komentet e saj, lidhur me draft – “Rregulloren për kushtet minimale të cilësisë së shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike”, të cilat janë reflektuar.
- Në shkresën e saj me nr. 524 Prot., i ERE, datë 06.07.2016 “Shoqata e Mbrojtjes së Tregtarëve dhe Tregut të Shqipërisë” lidhur me draft Rregulloren “Për kushtet minimale të cilësisë së shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike”, ka paraqitur komentet e saj, të cilat janë reflektuar.
- Në shkresën me nr. 575 Prot., datë 26.07.2016, ERE i ka kërkuar shoqërisë “OSHEE” sh.a, argumenta dhe shpjegime përkatëse, lidhur me nivelet e lejuara të treguesve të cilësisë së shërbimit të paraqitur prej saj.

- Me shkresën nr. 575/1 Prot., datë 04.08.2016, shoqëria “OSHEE” sh.a, ka dërguar argumentat dhe shpjegimet e saj lidhur me nivelet e lejuara të treguesve të cilësisë së shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike, të propozuar prej saj.
- Me shkresën me nr. 716 Prot., i ERE, datë 07.10.2016, kanë ardhur komente nga USAID mbi draft Rregulloren “Për kushtet minimale të cilësisë së shërbimit me energji elektrike”, duke propozuar vendosjen e një periudhe tranzitore lidhur me përmbushjen e këtyre detyrimeve, në kuadër të ristrukturimit të sektorit të energjisë elektrike dhe implementimit të Modelit të Ri të Tregut.
- Me shkresën nr. 775 Prot., datë 03.11.2016, ERE i ka dërguar edhe njëherë, për mendim, draftin e paraqitur nga USAID, të gjitha palëve të interesuara dhe grupeve të interesit.
- Në vijim të shkresës me nr. 775 Prot., datë 03.11.2016, kanë ardhur komente nga subjektet si MZHETTS, OST sh.a dhe Shoqata e Konsumatorit Shqiptar, të cilat kanë paraqitur opinionet e tyre, të cilat janë shqyrtuar dhe reflektuar rast pas rasti.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s,

#### **Vendosi:**

1. Të miratojë “Rregulloren për kriteret standarde të cilësisë së shërbimit të furnizimit dhe performancës së sigurisë së rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike”.
2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit, të njoftojë shoqërinë “OSHEE“ sh.a. dhe gjithë palët e interesuara për Vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

**Kryetari**  
**Petrit AHMETI**

[https://ere.gov.al/doc/RREGULLORE\\_PER\\_KRITERET\\_STANDARTE\\_TE\\_CILESISE\\_SE\\_SHERBIMIT\\_TE\\_FURNIZIMIT\\_DHE\\_PERFORMANCES\\_SE\\_SIGURISE\\_SE\\_RRJETIT\\_TE\\_SHPERNARJES\\_SE\\_ENERGJISE\\_ELEKTRIKE.pdf](https://ere.gov.al/doc/RREGULLORE_PER_KRITERET_STANDARTE_TE_CILESISE_SE_SHERBIMIT_TE_FURNIZIMIT_DHE_PERFORMANCES_SE_SIGURISE_SE_RRJETIT_TE_SHPERNARJES_SE_ENERGJISE_ELEKTRIKE.pdf)